



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI I REPUBLIKËS
REPUBLIC OF KOSOVO – PRESIDENT OF THE REPUBLIC
REPUBLIKA KOSOVA – PRESEDNIK REPUBLIKE

**DEKRET PËR RATIFIKIM TË MARRËVESHJES
NDËRKOMBËTARE**

Duke u bazuar në nenin 18, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në nenin 4, pika 3 të Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik,

D e k r e t o j

Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Mbretërisë së Belgjikës për Transferimin e Personave të Dënuar, të nënshkruar me datë 18 qershor 2010, dhe të pranuar në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës me datë 16 korrik 2010.

Marrëveshja e ratifikuar i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për njoftim, në përputhje me nenin 18, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Marrëveshja e ratifikuar hynë në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare.

Nr. i Dekretit: DMN-026-2010

Prishtinë, më 2 shtator 2010

Dr. Fatmir Sejdiu
President i Republikës së Kosovës

MARRËVESHJE

NDËRMJET

QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

DHE

QEVERISË SË MBRETËRISË SË BELGJIKËS

PËR

TRANSFERIMIN E PERSONAVE TË DËNUAR

**MARRËVESHJE
NDËRMJET
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
DHE
QEVERISË SË MBRETËRISË SË BELGJIKËS
PËR
TRANSFERIMIN E PERSONAVE TË DËNUAR**

QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

DHE

QEVERIA E MBRETËRISË SË BELGJIKËS

ME DËSHIRË për zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e ligjit penal;

DUKE MARRË parasysh që ky bashkëpunim do të zgjeronte diapazonin e drejtësisë dhe rehabilitimit social të personave të dënuar;

DUKE MARRË parasysh që këto objektiva kërkojnë që të huajve të cilëve u është hequr liria si rezultat i kryerjes së një veprë penale duhet t'u jepet mundësia e mbajtjes së dënimeve të tyre brenda shoqërisë së tyre vetanake;

DUKE MARRË parasysh që ky qëllim mund të arrihet më së miri duke i transferuar ata në vendet e tyre vetanake,

PAJTOHEN si vijon:

NENI 1
Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Marrëveshje:

1. “dënim” do të thotë çdo dënim apo masë që ka të bëjë me heqjen e lirisë, të vendosur nga një gjykatë për një periudhë kohe të caktuar ose të pacaktuar si rezultat i një vepre penale;
2. “vendim” është çdo vendim ose urdhër i gjykatës që shpall një dënim;
3. “Shteti” është Qeveria e Republikës së Kosovës, ose Qeveria e Mbretërisë së Belgjikës;
4. “Shteti dënues” është shteti në të cilin është shqiptuar dënimi për personin, i cili mund të transferohet ose është transferuar;
5. “Shteti zbatues” është shteti në të cilin personi i dënuar mund të jetë ose është transferuar për të vuajtur dënimin e tij;
6. “Autoriteti Qendror,” në rastin e Mbretërisë së Belgjikës nënkupton Departamentin Federal të Drejtësisë dhe, në rastin e Republikës së Kosovës, Ministrinë e Drejtësisë.

NENI 2
Parime të përgjithshme

1. Shtetet angazhohen t'i ofrojnë njëra-tjetrës masën më të gjerë të bashkëpunimit në lidhje me transferimin e personave të dënuar në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshje.
2. Një person i dënuar në territorin e një Shteti mund të transferohet në territorin e një Shteti tjetër, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshje, për të vuajtur dënimin që i është dhënë. Për këtë qëllim ai mund të shprehë interesin e vet tek Shteti dënues ose tek Shteti zbatues për transferimin e tij në përputhje me këtë Marrëveshje.
3. Transferimi mund të kërkohet nga Shteti dënues ose nga Shteti zbatues.

NENI 3
Kushtet për Transferim

1. Në përputhje me këtë Marrëveshje një person i dënuar mund të transferohet vetëm sipas kushteve që vijojnë:
 - a. nëse ai person është shtetas i Shtetit zbatues;
 - b. nëse vendimi është i formës së prerë;
 - c. nëse në kohën e pranimit të kërkesës për transferim, personi i dënuar ka ende të paktën një vit të dënimit për të vuajtur apo nëse dënimi është i pacaktuar;

- d. nëse personi i dënuar pajtohet me transferimin ose, duke marrë parasysh moshën ose gjendjen e tij fizike apo mendore dhe, kur njëri prej të dy Shteteve e konsideron atë si të nevojshme, nëpërmjet përfaqësuesit ligjor të personit të dënuar; përveç në rastet të përmendura në Nenet 8, 9 dhe 14;
 - e. nëse veprimet apo mosveprimet, në bazë të të cilave është dhënë dënimi, përbëjnë një vepër penale në përputhje me të drejtën e Shtetit zbatues ose do të përbënte një vepër penale nëse do të ishte kryer në territorin e tij; dhe
 - f. nëse Shteti dënuës dhe Shteti zbatues janë dakord me transferimin.
2. Në raste të veçanta, palët mund të bien dakord me një transferim edhe nëse koha që duhet të vuhet nga personi i dënuar është më e shkurtër se ajo e përcaktuar në paragrafin 1.c.

NENI 4

Obligimi i dhënies së informatave

1. Çdo person i dënuar për të cilin mund të zbatohet kjo Marrëveshje informohet nga Shteti dënuës mbi lëndën e kësaj Marrëveshje.
2. Nëse personi i dënuar i ka shprehur interes Shtetit dënuës për t'u transferuar në përputhje me këtë Marrëveshje, ai Shtet njofton Shtetin zbatues sa më shpejt që të jetë e mundur pasi vendimi të ketë marrë formë të prerë.
3. Informacioni përmbledh:
 - a. emrin, datën dhe vendin e lindjes së personit të dënuar;
 - b. adresën e tij, nëse ka, në Shtetin zbatues;
 - c. përshkrimin e fakteve mbi të cilat është bazuar dënimi; dhe
 - d. natyrën, kohëzgjatjen dhe datën e fillimit të dënimit.
4. Nëse personi i dënuar i ka shprehur interesin e vet Shtetit zbatues, Shteti dënuës me kërkesë i komunikon atij Shteti informacionin e përmendur në paragrafin 3 të mësipërm.
5. Personi i dënuar informohet me shkrim dhe në gjuhën të cilën ai e kupton për çdo veprim të ndërmarrë nga shteti dënuës ose zbatues në përputhje me paragrafin e mësipërm, si edhe për çdo vendim nga secili shtet lidhur me kërkesën për transferim.

NENI 5

Kërkesat dhe përgjigjet

1. Kërkesat për transferim dhe përgjigjet bëhen me shkrim.

2. I tërë komunikimi ndërmjet dy Shteteve mund të bëhet drejtpërdrejt prej njërit Autoritet Qendror në tjetrin.
3. Shteti të cilit i parashtrahet kërkesa duhet të informojë Shtetin që parashtron kërkesën me kohë për vendimin e tij rreth asaj se a pajtohet apo jo për transferimin e kërkuar.

NENI 6 Dokumentet shtesë

1. Shteti zbatues i paraqet Shtetit kërkuar (dënues), nëse kërkohet prej tij:
 - a. një dokument apo deklaratë që tregon se personi i dënuar është shtetas i atij Shteti;
 - b. një kopje të ligjit përkatës të Shtetit zbatues i cili parashikon që kryerja apo moskryerja e një veprimi për të cilin është dhënë dënimi në Shtetin dënues përbën një vepër penale në pajtim me ligjin e Shtetit zbatues apo do të përbënte një vepër penale nëse do të ishte kryer në territorin e tij.
2. Nëse bëhet kërkesë për një transferim, Shteti dënues i paraqet dokumentet e mëposhtme Shtetit zbatues, nëse njëri prej shteteve ka bërë të ditur se ai nuk është dakord me transferimin:
 - a. një kopje të vërtetuar të aktgjykimit dhe të ligjit mbi të cilin aktgjykimi bazohet;
 - b. një deklaratë ku tregohet se sa kohë e dënimit është vuajtur, duke përfshirë informatat për ndalimet paragjyqësore, shkurtimeve e dënimeve, si edhe për çdo faktor tjetër relevant që ka të bëjë me ekzekutimin e dënimit, siç është përfitimi i besimit për punën e kryer si dhe për sjellje të mirë;
 - c. përveç në rastet e përmendura në nenin 8 dhe 14, një deklaratë që përmban pëlqimin për transferim siç është dhënë në nenin 3.1.d ose, nëse është përkatëse, dokumentet e përmendura në nenin 9.3;
 - d. kur është e mundur, ndonjë raport mjekësor apo shoqëror për personin e dënuar, informacione për trajtimin e tij në Shtetin dënues dhe ndonjë rekomandim për trajtimin e tij të mëtejshëm në Shtetin zbatues. Ky informacion duhet të përfshijë raporte relevante të psikiatrit, psikologut, ose raporte për tentim vetëvrasje, informacion për gjendjen shëndetësore, duke përfshirë problemet me abuzimin e substancave, informacionin për trajtimin e mëhershëm dhe të tanishëm, ose raportet disiplinuese dhe të incidenteve gjatë kohës së mbajtjes në burgim, duke cekur ndonjë çështje të veçantë në lidhje me sigurinë.
3. Secili shtet mund të kërkojë të pajiset me çfarëdolloj dokumenti ose deklarate të përmendura në paragrafin 1 ose 2 të mësipërm para se të bëjë kërkesën për transferimin ose para marrjes së vendimit për rënien dakord për transferimin e tij ose jo.

NENI 7

Pëlqimi dhe konfirmimi i saj

1. Shteti dënues sigurohet që personi i kërkuar për të dhënë pëlqimin për transferimin në përputhje me nenin 3.1.d e bën këtë me vullnetin e tij dhe me dije të plotë për pasojat e tij dhe pas konsultimit me përfaqësuesin e pavarur ligjor. Procedura për dhënien e një pëlqimi të tillë udhëhiqet sipas ligjit të Shtetit dënues.
2. Para dhënies së pëlqimit, personi i cili duhet të japë një pëlqim të tillë për transfer duhet të informohet në lidhje me kushtet relevante të burgut, shërbimet e disponueshme si dhe programin për lirim në Shtetin zbatues.
3. Shteti dënues i jep mundësi Shtetit zbatues që të verifikojë nëpërmjet një konsulli ose një zyrtari tjetër, për të cilin është rënë dakord me shtetin zbatues, që pëlqimi është dhënë në përputhje me kushtet e përcaktuara të këtij neni.

NENI 8

Personat e ikur nga paraburgimi nga Shteti dënues

1. Në rastet kur shtetasi i një Pale i cili është subjekt i një dënimi të shqiptuar në territorin e Palës tjetër si pjesë e gjykimit përfundimtar orvatet t'i ikë ekzekutimit të mëtejme të dënimit në Shtetin dënues përmes të arratisjes në territorin e Palës së parë para se të ketë mbajtur dënimin, Shteti dënues mund të kërkojë nga Pala tjetër të merr përsipër ekzekutimin e dënimit.
2. Me kërkesë të Shtetit ku personi është i dënuar, Shteti zbatues mund, para arritjes së dokumenteve mbështetëse të kërkesës, ose para vendimit mbi këtë kërkesë, të arrestojë personin e dënuar apo të marrë çfarëdo qoftë mase tjetër për të siguruar që personi i dënuar të mbetet në territor të tij, në pritje të vendimit për kërkesën. Kërkesat për masa të përkohshme duhet të përfshijnë informatat e përmendura në paragrafin 3 të Nenit 4 të kësaj Marrëveshje. Pozita penale e personit të dënuar nuk duhet të përkeqësohet si rezultat i çfarëdo qoftë periudhe të kaluar në arrest, duke u bazuar në këtë paragraf.
3. Pëlqimi i personit të dënuar nuk do të kërkohet për transferimin e ekzekutimit të dënimit.

NENI 9

Personat e dënuar nën urdhëra për largim apo deportim

1. Kur t'i dërgohet kërkesë nga ana e Shtetit dënues, Shteti zbatues nën dispozitat e këtij Neni, mund të pajtohet me transferimin e personit të dënuar pa pëlqimin e atij personi, ku ekzekutimi i dënimit kalon në këtë të fundit, apo një vendim i rëndësishëm administrativ ndaj këtij dënimi përfshin një urdhër për largim apo deportim, apo çfarëdo qoftë masë tjetër si rezultat i së cilës ky person nuk do të lejohet më të mbesë në territorin e Shtetit dënues në atë moment kur ai apo ajo të lirohet nga burgu.
2. Shteti zbatues nuk do të japë pëlqimin e vet për arsye të paragrafit 1 para se të ketë marrë parasysh mendimin e personit të dënuar.

3. Me qëllim të zbatimit të këtij Neni, Shteti dënues do t'i sigurojë Shtetit zbatues:
 - a. një deklaratë që përmban mendimin e personit të dënuar rreth transferimit të tij apo saj dhe
 - b. një kopje të urdhërit për largim apo deportim, apo çfarëdo urdhër qoftë me efektin që personi i dënuar nuk do të lejohet më të mbesë në territorin e Shtetit dënues pasi ai apo ajo të jetë liruar nga burgju.
4. Kundër asnjë personi të transferuar nën dispozitat e këtij Neni nuk duhet të ngritet proces, të dënohet apo paraburgoset në lidhje me ekzekutimin e një aktgjykimi apo urdhër për paraburgim për çfarëdo qoftë shkelje të kryer para transferimit të tij apo saj, përveç për atë për të cilën ekzekutimi i dënimit është shqiptuar, e as nuk do të kufizohet ai apo ajo në lirinë e vet, përveç në rastet vijuese:
 - a. kur Shteti dënues ashtu autorizon: një kërkesë për autorizim duhet të parashtrohet, së bashku me të gjitha dokumentet relevante dhe të dhënave ligjore dhe çdo deklaratë të bërë nga personi i dënuar; autorizimi duhet të lëshohet kur vepra për të cilën kërkohet do të jetë subjekt i Ekstradimit sipas ligjit të shtetit dënues ose kur ekstradimi do të përjashtojë vetëm për shkaqe të lartësisë së dënimit;
 - b. kur personi i dënuar, pasi të ketë pasur mundësinë për t'u larguar nga Shteti zbatues, nuk e ka bërë këtë gjë brenda 45 ditëve nga lirimi i tij apo saj përfundimtar, ose nëse ai apo jo është rikthyer prapë në atë territor pas largimit.
5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 4, Shteti zbatues mund të marrë çfarëdo masa të nevojshme sipas ligjit të tij, duke përfshirë procedurat në mungesë (in absentia), për të parandaluar efektet juridike të parashkrimit të ndjekjes penale.

NENI 10

Efektet e transferimit për shtetin dënues

1. Marrja përsipër e personit të dënuar nga autoritetet e Shtetit zbatues sjell si rezultat pezullimin e ekzekutimit të dënimit në Shtetin dënues.
2. Shteti dënues nuk mund të ekzekutojë më tej dënimin, nëse shteti zbatues e konsideron ekzekutimin e dënimit si të përfunduar.

NENI 11

Efektet e transferimit për Shtetin zbatues

1. Autoritetet kompetente të Shtetit zbatues duhet të:
 - a. vazhdojnë me ekzekutimin e dënimit menjëherë ose përmes të urdhëresës gjyqësore apo administrative, nën kushtet e dhëna në Nenin 12, ose

- b. shëndrojnë dënimin, përmes një procesi gjyqësor apo administrativ, në një vendim të atij Shteti, duke zëvendësuar së këndejmi sanksionin e shqiptuar në Shtetin dënues me një sanksion të caktuar me ligjin e Shtetit zbatues për veprën e njëjtë, nën kushtet e dhëna në Nenin 13.
2. Shteti zbatues, nëse kërkohet nga ai, duhet të informojë Shtetin dënues para transferimit të personit të dënuar rreth asaj se cilat nga këto procedura do t'i ndjekë.
3. Ekzekutimi i dënimit do të udhëhiqet sipas ligjit të Shtetit zbatues dhe vetëm ky Shtet do të jetë kompetent për të ndërmarrë të gjitha vendimet e duhura.

NENI 12

Ekzekutimi i vazhduar

1. Në rast të ekzekutimit të vazhduar, Shteti zbatues do të jetë i lidhur nga natyra juridike dhe kohëzgjatja e dënimit, ashtu siç është paraparë nga Shteti dënues.
2. Nëse, megjithatë, ky dënim është për nga natyra apo kohëzgjatja e vet inkompatibil me ligjin e Shtetit zbatues apo ligjin e tij, përmes një procedure gjyqësore ose administrative, organet kompetente të shtetit zbatues duhet ta konvertojnë dënimin në një vendim të atij Shteti, duke zëvendësuar kështu sanksionin e dhënë nga Shteti dënues me një sanksion të parashikuar nga ligji i shtetit zbatues për të njëjtën veprë penale. Sa i përket natyrës së vet, dënimi apo masa duhet që, sa më shumë që është e mundur, të korrespondojë me atë të shqiptuar për ekzekutimin e dënimit. Ai nuk duhet të përkeqësojë, me natyrën apo kohëzgjatjen e vet, sanksionin e shqiptuar në Shtetin dënues, e as të tejkalojë maksimumin e caktuar me ligj të Shtetit zbatues.

NENI 13

Konvertimi i dënimit

1. Në rastin e konvertimit të dënimit zbatohen procedurat e parashikuara nga ligji i shtetit zbatues. Kur bëhet konvertimi i dënimit, organi kompetent:
 - a. duhet t'u përmbahet konstatimeve për faktet kur ato shfaqen qartë dhe shprehimisht nga vendimi i dhënë nga shteti dënues;
 - b. nuk mund të konvertojë një dënim me burgim në një dënim me gjobë;
 - c. shkurton periudhën e plotë të heqjes së lirisë që është duke u vuajtur nga personi i dënuar;
 - d. nuk e rëndon dënimin e personit të dënuar dhe nuk është i detyruar t'i përmbahet ndonjë minimumi që mund të parashikojë ligji i Shtetit zbatues për veprën ose veprat e kryera.
2. Nëse procedura e konvertimit kryhet pas transferimit të personit të dënuar, shteti zbatues e mban atë person në ndalesë ose siguron në ndonjë mënyrë tjetër praninë e tij në shtetin zbatues, derisa të dalë rezultati i procedurës.

NENI 14

Lirimi me kusht dhe sprovues

1. Kur një shtetas i një Shteti i nënshtrohet vendimit për suspendim me kusht apo mbajtje me kusht të dënimit ose të urdhëresës për paraburgim, ose kur dënohet me kusht apo i liruar me kusht në territorin e Shtetit tjetër, ky i fundit mund të kërkojë nga ai i pari të merr përsipër mbikëqyrjen e këtyre kushteve.
2. Kjo marrje përsipër e mbikëqyrjes së kushteve nuk kërkon miratimin e palës së interesuar.
3. Shteti nga i cili kërkohet mund, me urdhëresë gjyqësore apo administrative, të adaptojë kushtet në lidhje me aktgjykimin, suspendimin, mbajtjen apo lirimin ndaj nevojave të legjislacionit vetanak, duke njoftuar Palën tjetër. Natyra dhe kohëzgjatja e këtyre kushteve të reja duhet të korrespondojë sa më shumë të jetë e mundur me kushtet fillestare. Natyra e tyre nuk duhet të përkeqësojë situatën e palës së interesuar.
4. Kur personi i dënuar thyen kushtet që i janë shqiptuar, Shteti të cilit i dërgohet kërkesa duhet të revokojë vendimin mbi suspendimin me kusht, mbajtjen me kusht të dënimit apo lirimin me kusht. Shteti të cilit i bëhet kërkesa atëherë do të merr përsipër ekzekutimin e dënimit apo urdhëresën për paraburgim që jepet nga Shteti dënues.

NENI 15

Falja, Amnestia ose zëvendësimi

Secili shtet mund të japë Amnesti ose zëvendësim të dënimit në përputhje me ligjet e saj, po që se aktet e tilla janë të aplikuara në përgjithësi. Secili shtet mundet me pëlqimin e shtetit dënues dhe në përputhje me ligjet e saj të jap falje.

NENI 16

Rishqyrtimi i vendimit

Vetëm Shteti dënues ka të drejtën për të vendosur mbi çdo kërkesë për rishqyrtimin e vendimit.

NENI 17

Përfundimi i Ekzekutimit

Shteti zbatues përfundon ekzekutimin e dënimit menjëherë sapo të informohet nga Shteti dënues për çdo vendim ose masë si rezultat i të cilit dënimi duhet të përfundojë.

NENI 18
Informacioni për ekzekutimin

Shteti zbatues i jep informata Shtetit dënues në lidhje me ekzekutimin e dënimit:

- a. kur ai e konsideron ekzekutimin e dënimit të përfunduar;
- b. nëse personi i dënuar është arratisur nga mbajtja para se të përfundojë ekzekutimin e dënimit; ose
- c. kur Shteti dënues kërkon një raport të veçantë.

NENI 19
Gjuha dhe shpenzimet

1. Për zbatimin e kësaj Marrëveshje, informatat do të përcillen në një nga gjuhët vijuese:
 - a. Shqip, serbisht apo anglisht në rast se i adresohet Republikës së Kosovës;
 - b. Frëngjisht, holandisht apo anglisht në rast se i adresohet Mbretërisë së Belgjikës.
2. Përveç kufizimit të parashikuar në nenin 6.2.a, dokumentet e transmetuara në zbatim të kësaj Marrëveshje nuk nevojitet të vërtetohen.
3. Të gjitha shpenzimet e dala si rezultat i zbatimit të kësaj Marrëveshje duhet të mbulohen nga Shteti zbatues, përveç shpenzimeve të dala ekskluzivisht në territorin e Shtetit dënues dhe shpenzimet në lidhje me transportimin e personit të dënuar deri në kufi të Shtetit administrues ose, në rast të transportimit ajror, deri në aeroportin e destinacionit përfundimtar, përveç nëse Shtetet merren vesh ndryshe në një rast specifik.

NENI 20
Dispozitat përfundimtare

1. Kjo Marrëveshje i nënshtrohet ratifikimit dhe do të hyjë në fuqi tridhjetë ditë pas shkëmbimit të instrumenteve të ratifikimit.
2. Kjo Marrëveshje është e zbatueshme për ekzekutimin e dënimeve të dhëna para ose pas hyrjes së saj në fuqi.

3. Secili Shtet mund të anulojë këtë Marrëveshje në cilëndo kohë duke i dërguar një njoftim me shkrim Palës tjetër përmes të kanaleve (qarqeve) diplomatike. Anulimi do të hyjë në fuqi një vit nga data e pranimit të këtij njoftimi. Marrëveshja e tanishme, megjithatë, do të vazhdojë të jetë e zbatueshme për ekzekutimin e dënimeve të personave të cilët janë transferuar në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes para datës në të cilën ka hyrë në fuqi shfuqizimi.

NË CILËSINË E DËSHMITARËVE të nënshkruarit, përkatësisht të autorizuar, e kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.


KRYER në Bruksel, më 18 qershor 2010, në gjuhët franceze, holandeze, shqipe, serbe dhe angleze, të gjitha tekstet njësoj autentike. Në rast të dallimit në përkthim të teksteve të kësaj Marrëveshje versioni në anglisht do të mbizotërojë dhe do të jetë valid.

**PËR QEVERIN E REPUBLIKËS
SË KOSOVËS:**



Hashim THACI,
Kryeministër

**PËR QEVERIN E MBRETËRISË
SË BELGJIKËS:**



Yves LETERME,
Kryeministër